



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr.1177/1 prot.

Tiranë, më 30.6.2023

Lënda: Mendim mbi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 155/2015,
“Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE TË EKONOMISË

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj me nr. 11546 prot., datë 22.06.2023, protokolluar me tonën me nr. 1177 prot., datë 26.06.2023, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “projektligji”), si dhe dokumentet shoqëruese.

Nga shqyrtimi i projektaktit, Zyra e Komisionerit vlerëson se në tërësi, ky projektligj zbaton standardet e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji”). Megjithatë, do të vlerësonim marrjen në konsideratë, nga ana juaj, të sugjerimit në vijim.

Në nenin 14 të këtij projektligji, parashikohet detyrimi për regjistrimin paraprakisht të çdo lojtari që do të marrë pjesë në baste sportive online, si dhe ruajtjen e të dhënave për identitetin e tyre, për të paktën 3 vjet. Zyra e Komisionerit vlerëson se, në hartimin e kësaj dispozite apo dispozitave të tjera, ku parashikohen afate për ruajtjen e të dhënave personale, duhet të mbahet në konsideratë parimi i sanksionuar në pikën 1/d, të nenit 5 të Ligjit, i cili parashikon se: “Mbrojtja e të dhënave personale bazohet në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej”.

Mbështetur në përcaktimet e këtij parimi, Zyra e Komisionerit vlerëson se, në tërësi, në ndryshimet që ky projektligj do të sjellë, duhet të rishikohen afatet për mbajtjen e të dhënave të lojtarëve, të cilat duhet të jenë në përputhje me qëllimin, si dhe të mos e tejkalojnë atë.

Me përfshirjen e sugjerimit të mësipërm, projektligji vlerësohet i hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi